

# **KONCESIONE / PARTNERITET** **PUBLIK PRIVAT**

## **MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURES**

Zotit. Ziad Saman Hamzeh  
Catalyst Salillari Violaip Bee Tech Kastrati Consortium  
Khalidia ST. Bllg, Shaika Muhra Bint Khalid Al Nahyan P.O.110894 ,  
Abu Dhabi

### **Njoftimi i Ofertuesit të Përzgjedhur**

I nderuar z. Hamzeh,

Më 27 prill 2016, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë (MTI) lëshoi një Kërkesë për Propozime (KP) me qëllim për të dhënë me koncesion për të përmirësuar, operuar dhe mirëmbajtur autostradën Milot - Morinë ("Projekti").

Më 30 maj 2016, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i zgjedhur nga MTI hapi ofertat e dorëzuara për Projektin.

Ofertuesit e mëposhtëm Potencial morën pjesë në tender duke ofruar respektivisht:  
Një Konsorcium i përbërë nga CATALYST VIVA DAS GENERAL CONTRACTING LLC (EBA) - SALILLARI LTD (Shqipëri) - BEE TECH (Greqi) - VIOLIAP ATEVE (Greqi) - KASTRATI SA (Shqipëri) ("Konsorciumi Catalyst") dorëzoi një ofertë për Projektin para përfundimit të Afatit të Dorëzimit të përmendur në klauzolën 2.2.1 të KP në vlerën prej 4,995,000 Euro (katër milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë Euro).

Një Konsorcium i përbërë nga VENDEKA (Turqi) - CIIRA (Indonesia) - MAU (Turqi) - SAVRONIK (Turqi) - VENDEKA EUROPEAN (Turqi) ("Konsorciumi Vendeka") dorëzoi një ofertë për Projektin para përfundimit të Afatit të Dorëzimit të përmendur në klauzolën 2.2.1 të KP në vlerën prej 5,600,000 euro (pesë milionë e gjashtëqind mijë euro).

Më 29 gusht 2016, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi ta skualifikojë Konsorciumin Vendeka dhe të para kualifikojë Konsorciumin Catalyst, si dhe ta përcaktojë atë si Ofertuesin e Preferuar.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e Republikës së Shqipërisë njofton Konsorciumin Catalyst se Oferta e dorëzuar më 30 maj 2016, në lidhje me Projektin PPP të autostradës Milot - Morinë është pranuar.

Brenda 7 ditëve nga data e këtij Njoftimi të Ofertuesit të Përzgjedhur, Konsorciumi Catalyst duhet t'i dorëzojë MTI-së pranimin e Njoftimit të Ofertuesit të Përzgjedhur, duke rënë dakord të pajtohet me kushtet e përcaktuara këtu dhe të ekzekutojë marrëveshjen e koncesionit.

Në rast se Konsorciumi Catalyst nuk dëshiron të nënshkruajë marrëveshjen e koncesionit, ju duhet të njoftoni MTI-në me shkrim.

Pavarësisht nga dispozitat e klauzolës 11 të KP, nëse Konsorciumi Catalyst dështon të përmbushë kushtet:

- brenda 7 ditëve të këtij Njoftimi të Ofertuesit të Përzgjedhur, të dorëzojë pranimin e rënies dakord të pajtohet me kushtet e përcaktuara këtu dhe të ekzekutojë marrëveshjen e koncesionit, ose
- brenda 30 ditëve të këtij Njoftimi të Ofertuesit të Përzgjedhur, t'i paguajë MTI-së tarifën në vlerën prej 20.000 euro, siç përcaktohet në klauzolën 6.2 të KP, ose
- brenda 60 ditëve të këtij Njoftimi të Ofertuesit të Përzgjedhur, të ekzekutojë Marrëveshjen e Koncesionit në varësi të dispozitave të klauzolës 19.3 të KP, ose
- brenda 5 ditëve nga ekzekutimi i marrëveshjes së koncesionit, të dorëzojë Sigurimin e Kontratës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në klauzolat 2,4-2,6 e marrëveshjes së koncesionit

atëherë do të përbejnë arsye të mjaftueshme për anulimin e këtij Njoftimi të Ofertuesit të Përzgjedhur dhe konfiskimin e Garancisë së Ofertës të lëshuar nga Konsorciumi Catalyst.